



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 110/4 Prot.

Tiranë, më 09.3 2016

REKOMANDIM

Nr. 04 datë 09.3 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, në ngarkim të klinikës-kontrolluesit, "*Bylykbashi*", me formë ligjore të aktivitetit, person fizik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.13, datë 28.01.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u realizua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, si më lart cituar, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat e për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Gjatë kryerjes së veprimeve administrative procedurale, në datat 29.01.2016 e vazhdim, pranë këtij kontrolluesi, grupi i kontrollit konstatoi:

- 1- Kontrolluesi, klinika "*Bylykbashi*" p.f., ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë, dhe **nuk** ka njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, në zbatim të nenit 21-22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*". i ndryshuar.
- 2- Kontrolluesi, klinika "*Bylykbashi*" p.f., ka reaguar në datë 05.02.2016, duke depozituar pranë protokollit të Zyrës së Komisionerit, Formularin e Njoftimit të plotësuar.
- 3- Kontrolluesi, klinika "*Bylykbashi*" p.f., ka një rregullore modeste, në funksion të aktivitetit modest dhe me kohë të pjesshëm të tij, në të cilën janë përfshirë disa parime bazë mbi konfidencialitetin, por jo e detajuar sipas standardeve të parashikuara në Ligjin

Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të tij nënligjore.

- 4- Kontrolluesi, klinika "Bylykbashi" p.f., e ka të parashikuar në rregullore deklaratën e konfidencialitetit për punëmarrësit, (edhe pse janë të vetëpunësuar), por jo sipas standardit të parashikuar detyruës të Vendimi nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, detyrimisht të hartohet rregullorja sipas standarteve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri dhe në përshtatshmëri të interesave të kontrolluesit.
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, detyrimisht të hartohet "Deklarata e Konfidencialitetit", sipas standardit të parashikuar në Vendimin Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit.
3. Kontrolluesi, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, duhet ti realizojë brenda një afati kohor, prej 30 ditësh.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 09.3.2016

